




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Odeljenje za Kulturę, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport



13 Nr. Zyrtar – 2025

Drejtoria e Kulturës, Komuna e Rahovecit, në bazë të rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Rahovecit, si dhe në bazë të rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, hap:

THIRRJE PUBLIKE – RINI DHE SPORT

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve për klubet e sportit dhe të OJQ-ve rinore, për organizimin e aktiviteteve sportive e rinore në Komunën e Rahovecit gjatë vitit 2025:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit u bën thirrje klubeve të sportit dhe shoqatave sportive e rinore të regjistruara në Republikën e Kosovës, me program të punës të fokusuar në sport dhe aktivitete rinore, që të aplikojnë për mbështetje financiare për realizimin e projekteve të tyre. Thirrja synon të mbështesë përfshirjen sa më të madhe të të rinjve në aktivitete sportive dhe rinore, duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Rini dhe Sport, në Komunën e Rahovecit në masovizimin e sportit dhe aktivizmin rinor.

- Klubet sportive dhe shoqatat rinore mund të aplikojnë vetëm me një projekt, që mund të kontribuojë në organizimin me sukses të aktiviteteve sportive dhe pjesëmarrje në gara sportive, si dhe në përfshirjen sa më të gjerë të të rinjve në jetën kulturore, rinore e sportive në komunën e Rahovecit.

DKRS synon që përmes kësaj thirrjeje të ndikojë në:

- Masivizimin e sportit;
- Ngritjen e kapaciteteve në fushën e sportit;
- Organizimin e aktiviteteve sportive;
- Promovimin e vullnetarizmit tek të rinjtë;
- Integrimi i të rinjve dhe grupeve të marginalizuara
- Fuqizimin e organizatave rinore (seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjve etj.)
- Edukimin joformal (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsim).

- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt është katërqind euro(400 €), ndërsa shuma maksimale për një projekt është dyzet mijë euro (40.000 €).

- Mbështetja financiare e klubeve sportive bëhet në bazë të nivelit garues.
- Afati për dorëzimin e projekteve është nga 19.02.2025 deri më 12.03.2025.
- **Periudha e zbatimit të projektit dhe raportimit financiar është deri në fund të dhjetorit 2025.**
- **Propozimet dhe dokumentet e kompletuara sillen në zarf të myllur në 3 kopje dhe të dorëzohen në objektin e Komunës së Rahovecit, në sportelin nr.7 Rr. „Dëshmorët e Pashtrikut” pn, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 15:30.**

Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për Sport dhe Rini:

- Të drejtë aplikimi kanë klubet, shoqatat dhe OJQ-të rinore, të cilat aktivitetin e tyre e realizojnë në Komunën e Rahovecit.
- Klubet, shoqatat dhe OJQ-të rinore, mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit fiskal nga Komuna e Rahovecit;
- Klubet, shoqatat dhe OJQ-të rinore, që nuk e kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të vitit paraprak, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Rahovecit në këtë thirrje;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime të tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe të organizatës buxhetore apo të institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- Klubet, shoqatat dhe OJQ-të rinore nuk mund të përfitojnë dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Rahovecit brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme. Si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Rahovecit.
- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë klubet dhe OJQ-të, që janë të regjistruara si OJQ, në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës.
- Klubet, shoqatat dhe OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat e cekura më lartë.
- Aplikacionet me dokumentacion të pakompletuar do të eliminohen nga subvencionimi.
- Pas përfundimit të afatit të thirrjes publike nuk pranohen aplikacioni.
- Sjellja e dokumenteve të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë, konsiderohet si mungesë e dokumentit, prandaj komisioni mund të japë afat shtesë për zëvendësimin e dokumentit të dëmtuar ose që nuk mund të lexohet qartë.
- Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individë në cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjta vlen edhe për ndryshim të xhirollogarisë.
- Të gjithë aplikuesit të cilët i kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë në këtë thirrje publike e të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: arsim.kastrati@rks-gov.net, ose në numrin e tel.: +38344834474

Lista e dokumenteve të thirrjes publike:

Për klube/shoqata:

- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e nr. fiskal;
- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopja e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
- Vërtetimi që OJQ/klubi/shoqata nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Vërtetimi i DKRS-së, për mbylljen e raportit të vitit paraprak.

Projekt-propozimet duhet të përmbajnë:

Agjendën, aktivitetet, planifikimin dhe linjat buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit.

- 1.1 Formulari i aplikacionit (shkarko)
- 1.2 Formulari i buxhetit (shkarko)
- 1.3 Formulari i ndarjes buxhetore të projektit (shkarko)
- 1.4 Deklarata e përshtatshmërisë (shkarko)
- 1.5 Deklaratën për financim të dyfishtë (shkarko)

Vërejtje/Kujdes: Të gjitha aplikimet që nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren shqyrtim.

Rahovec, shkurt 2025

Drejtori i DKRS-së



Afrim Dina